

24 qershor 2023

Llojet e sanksioneve amerikane

Sanksionet në përgjithësi mund të ndahen në dy kategori:

- **Sanksionet primare** që zbatohen ndaj individëve dhe entiteteve nga ShBA-të ose në situatat kur ekziston një lidhje direkte me ShBA-të, si p.sh. përfshirja e një individi apo entiteti amerikan, e mallrave me origjinë amerikane, ose e një transaksioni që ndodh brenda ShBA-ve.
- **Sanksionet dytësore** autorizojnë OFAC-un ose Departamentin e Shtetit për të zbatuar sanksione ndaj një individëve dhe subjekteve jo amerikane, për aktivitete të caktuara, edhe nëse këto aktivitete nuk kanë lidhje me ShBA-të.

ShBA-të momentalisht zbatojnë me dhjetra programe sanksionesh, të cilat mund të jenë gjithëpërfshirëse ose të targetuara.

- **Sanksione gjithëpërfshirëse**, të quajtura gjithashtu embargo, që zakonisht ndalojnë çdo tregti me një vend apo rajon të caktuar. Aktualisht, ShBA-të zbatojnë sanksione gjithëpërfshirëse ndaj Kubës, Iranit, Koresë së Veriut, Sirisë dhe rajonit të pushtuar të Krimesë në Ukrainë. ShBA-të gjithashtu kanë vendosur programe masive sanksionesh ndaj Rusisë dhe Venezuelës.
- **Sanksione të targetuara** kundër individëve dhe entiteteve të caktuara, të cilat zakonisht u ndalojnë individëve dhe entiteteve amerikane të bëjnë transaksione me subjektin e

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) vendosin sanksione ekonomike dhe tregtare ndaj individëve, subjekteve dhe juridiksioneve në të gjithë botën, bazuar në politikën e jashtme dhe qëllimet e sigurisë kombëtare të ShBA-ve. Këto masa zbatohen kryesisht nga Zyra për Kontrollin e Pasurive të Huaja (OFAC) të Departamentit të Thesarit. Departamentet tjera si ai i Shtetit, i Tregtisë dhe i Mbrojtjes luajnë poashty role të rëndësishme në procesin e vendosjes së sanksioneve.

përcaktuar publikisht nga Departamenti i Shtetit ose ai i Thesarit në përputhje me kriteret individuale të listimit nën ndonjë regjim specifik sanksionesh. Në sanksionet e targetuara, bëjnë pjesë programe siç janë ai kundër terrorizmit, kundër trafikimit të narkotikëve, sanksionet globale Magnitsky, sanksionet kundër përhapjes së armëve bërthamore apo sanksionet për siguri kibernetike.ⁱ

OFAC-u mban Listën e shtetasve të përcaktuar posaçërisht dhe të personave të bllokuar ("Specially Designated Nationals And Blocked Persons List", SDN) si dhe listat e tjera të sanksioneve. Këto lista janë të qasshme publikisht në faqen e internetit të OFAC-ut.ⁱⁱ

Efkti i listës SDN është zakonisht se të gjitha asetet e individëve dhe subjekteve të përcaktuara si dhe të çdo filial ku një SDN zotëron së paku 50% të aksioneve dhe që gjinden brenda juridiksionit amerikan, duhet të bllokohen. Veç kësaj, shtetasëve amerikanë u ndalohet të angazhohen në çdo lloj transaksioni në të cilin një SDN ka ndonjë interes si dhe në çdo entitet në të cilin një SDN zotëron aksione prej së paku 50% (drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte) ka një interes.ⁱⁱⁱ

Vendet me rrezikshmëri të lartë :

ShBA-të konsiderojnë një sërë vendesh si "vende me rrezikshmëri të lartë" sepse ato janë subjekt i një programi sanksionesh të zbatuar nga OFAC ose nga to kanë prejardhje një numër i madh individësh të sanksionuar. Në këtë listë bëjnë pjesë Ballkani Perëndimor dhe shtetet në vijim: Afganistani; Autoriteti Palestinez; Bjellorusia; Burundi; Hong Kong; Iraku; Jemeni; Kolumbia; Libani; Libia; Meksika; Pakistani; Panama; Republika e Afrikës Qendrore; Republika Demokratike e Kongos; Republika Popullore e Kinës; Rusia; Somalia; Sudani; Sudani i Jugut; Ukrainë; Venezuela; dhe Zimbabve.

Regjimi i sanksioneve për Ballkanin Perëndimor

Ballkani Perëndimor, apo më saktë thënë vendet e ish-Jugosllavisë, kanë pasur regjim të dedikuar të sanksioneve që nga viti 2001. Më 26 qershor 2001, Presidenti George W. Bush nënshkroi **Urdhrin Ekzekutiv 1321**^{iv} mbi "Bllokimin e pronës së personave që kërcënojnë përpjekjet ndërkombëtare për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor". Urdhri Ekzekutiv 13219 u ndryshua në 2003 përmes **Urdhrit Ekzekutiv 13304**.^v

Këto Urdhëra Ekzekutive shpallën emergjencë kombëtare amerikane për të adresuar kërcënim për sigurinë kombëtare dhe politikën e jashtme të ShBA-ve të paraqitur nga veprimet e personave të përfshirë ndër tjera në:

- dhunë ekstremiste në Ballkanin Perëndimor;
- akte që pengojnë zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit; Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë së OKB-së; Marrëveshjes së Dejtonit dhe dokumentet e tij përcjellës; ose

efektshmërinë e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe mekanizmin e tij rezidual.

169 persona, individë dhe subjekte, të perceptuar si minuese të paqes në republikat e ish-jugosllave u vendosën në listën SDN. Në Maqedoninë e Veriut, kjo listë përfshinte ndër të tjerë Ljube Boshkovskin, Menduh Thaçin, Xhevat Ademin, Xhezair Shaqirin dhe entitete si Armata Kombëtare Shqiptare.

Këta dy urdhra ekzekutiv udhëzuan qeverinë amerikane të bllokonte pronat dhe interesat pronësore të personave të përcaktuar nën regjimin e sanksioneve. Për më tepër, personave nga ShBA-të u është ndaluar të angazhoheshin me apo në favor të personave e përcaktuar në çfarëdo transaksioni financiar, të mallrave apo të shërbimeve.

Përveç përmes Urdhrit Ekzekutiv 13304, shtetas dhe subjekte të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë sanksionuar nga ShBA për aktivitete të ndryshme kriminale edhe përmes instrumenteve tjera sanksionuese siç janë:

- **Rregulloret e sanksioneve kundër baronëve të huaj të trafikimit me narkotikë** (Kodi 31 i rregulloreve federale, pjesa 598, SDNTK): individët dhe subjektet e sanksionuara janë në Serbi (1); Mal të Zi (2), Kosovë (3) dhe Bosne-Hercegovinë (2).
- **Rregulloret e Sanksioneve të terrorizmit global** (Kodi i 31 Rregulloreve Federale, pjesa 594, SDGT): individët dhe subjektet e sanksionuara janë në Serbi (1); Kosovë (1); Bosne-Hercegovinë (8) dhe Shqipëri (3).
- **Urdhri Ekzekutiv 13818** i datës 20 dhjetor 2017 për bllokimin e pronës së personave të përfshirë në abuzim të rëndë të të drejtave të njeriut ose në korrupsion të rëndë (**Akti Global Magnitsky**, GLOMAG): individët dhe subjektet e sanksionuara janë që të gjitha serbe, përfshirë 28 në Serbi dhe 25 në Kosovë.

- **Urdhri ekzekutiv 13662 i datës 24 mars 2014 për bllokimin e pronës së personave shtesë që kontribuojnë në situatën në Ukrainë (UKRAINE-EO13662):** një (1) subjekt në Serbi (1).
- **Urdhri Ekzekutiv 14059 i datës 15 dhjetor 2021 për vendosjen e sanksioneve ndaj personave të huaj të përfshirë në tregtinë e paligjshme globale të drogës (ILLICIT-DRUGS-EO14059):** një (1) individ në Bosne-Hercegovinë.
- **Urdhri ekzekutiv 14024 i datës 15 prill 2021 për bllokimin e pronës në lidhje me veprimtaritë e huaja të dëmshme të specifikuar të Qeverisë së Federatës Ruse (RUSSIA-EO14024):** një (1) subjekt në Shqipëri.

Paradigma e re e Presidentit Biden: sanksionimi i politikanëve dhe zyrtarëve të korruptuar në Ballkanin Perëndimor

Ardhja e Presidentit Joe Biden në krye të ShBA-vë shënoi një ndërrim të vërtetë paradigme në lidhje me regjimin e sanksioneve të ShBA-ve për Ballkanin Perëndimor: sanksionet amerikane u bënë mjet për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë, me fokus të veçantë te politikanët dhe zyrtarët e lartë shtetëror.

Përcaktimi publik i Sali Berishës për shkak të përfshirjes në korrupsion masiv

Vetëm 4 muaj pas fillimit të mandatit të Bidenit, më 19 maj 2021, Sali Berisha, ish-president dhe ish-kryeministër i Shqipërisë u përcaktua publikisht nga Departamenti i Shtetit për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion masiv dhe u shpall persona non grata në ShBA.

Baza ligjore e përdorur për të sanksionuar Berishën ishte Seksioni 7031(c) mbi anti-kleptokracinë dhe të drejtat e njeriut i Ligjit buxhetor të vitit 2021 të Departamentit të Shtetit, operacioneve të jashtme dhe programeve të ndërlidhura.

Në njoftimin për shtyp të Sekretarit të Shtetit Anthony Blinken theksohet se “Në cilësinë e tij zyrtare si Kryeministër i Shqipërisë në veçanti, Berisha ishte i përfshirë në akte korruptive, si shpërdorimi i fondeve publike dhe ndërhyrja në proceset publike, duke përfshirë përdorimin e pushtetit të tij për përfitimin e tij dhe për të pasuruar aleatët e tij politikë dhe anëtarët e familjes së tij në kurriz të besimit të publikut shqiptar në institucionet e tyre qeveritare dhe zyrtarët publikë. Për më tepër, retorika e tij tregon se ai është i gatshëm të mbrojë veten, anëtarët e familjes dhe aleatët e tij politikë në kurriz të hetimeve të pavarura, përpjekjeve kundër korrupsionit dhe masave të llogaridhënies.”^{vi}

Përveç Sali Berishës, Departamenti i Shtetit vendosi masa sanksionuese edhe për bashkëshorten, djalin dhe vajzën e tij. Përcaktimi i Berishës nuk u shoqërua me sanksione ekonomike.

Urdhri Ekzekutiv 14033 për "Bllokimin e pronës dhe pezullimin e hyrjes në Shtetet e Bashkuara të personave të caktuar që kontribuojnë në situatën destabilizuese në Ballkanin Perëndimor"

Më 3 qershor 2021, Presidenti Biden lëshoi një **memorandum presidencial që shpalli luftën kundër korrupsionit si interes nacional amerikan**. Për herë të parë, ShBA-të u paisën me një strategji presidenciale për të luftuar korrupsionin në vendet partnere.

Menjëherë pas kësaj, më 8 qershor 2021, Presidenti Biden nënshkroi Urdhrin Ekzekutiv 14033 për “Bllokimin e pronës dhe pezullimin e

hyrjes në Shtetet e Bashkuara të personave të caktuar që kontribuojnë në situatën destabilizuese në Ballkanin Perëndimor”.^{vii}

Urdhri ekzekutiv 14033 zgjeron spektrin e sanksioneve amerikane, duke përfshirë Shqipërinë në fushëveprimin gjeografik si dhe duke shtuar, karshi shkaqeve ekzistuese të sanksioneve, minimin e Marrëveshjes së Prespës, korrupsionin dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut. Ky urdhër ekzekutiv vlerëson se korrupsioni endemik në vendet e Ballkanit Perëndimor është bërë pengesa kryesore për integrimin e tyre në institucionet transatlantike.

Në zbatim të Urdhrit Ekzekutiv 14033, deri më tani, 18 individë dhe subjekte të cilët janë vënë nën sanksione ekonomike dhe nën ndalesa udhëtimi drejt ShBA-ve:

- Marinko Çavara:** si ish President e Bosnje-Hercegovinës, Çavara ka bllokuar funksionimin e Gjykatës Kushtetuese duke refuzuar të emërojë gjyqtarë. U përcaktua si përgjegjës për minimin e proceseve demokratike si dhe të sigurisë, paqes dhe bashkëpunimit rajonal.
- Millorad Dodik:** anëtar i Presidencës së Bosnje-Hercegovinës, i përcaktuar në përgjigje të aktiviteteve të tij korruptive dhe kërcënimeve të vazhdueshme ndaj stabilitetit dhe integritetit territorial të Bosnje-Hercegovinës.
- Nikola Gruevski:** ish-kryeministër i Maqedonisë së Veriut, i dënuar dhe i dyshuar për shumë raste korruptive, shpërdorim detyre, pastrim parash dhe vepra të tjera kriminale, i përcaktuar për përfshirje në korrupsion.
- Diana Kajmakoviç:** prokurore shtetërore në Bosnje-Hercegovinë, e përcaktuar për përfshirje në korrupsion dhe minim të proceseve demokratike.
- Svetozar Maroviç:** ish-President i Serbisë dhe Malit të Zi, i përcaktuar për përfshirje në korrupsion.
- Osman Mehmedagiç:** ish-Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurisë së Inteligjencës të Bosnje-Hercegovinës, i përcaktuar për përfshirje në korrupsion.

7. **Sasho Mijalkov:** ish-shef i kundërzbulimit në Maqedoninë e Veriut, i përcaktuar për minimin e proceseve dhe institucioneve demokratike.

8. **Ylli Bahri Ndroqi:** pronar i medias në Shqipëri, pasuritë e të cilit u sekuestruan nga qeveria në vitin 2020 dhe 2021 për veprimtari kriminale, i përcaktuar për përfshirje në korrupsion.

9. **Fadil Novaliç:** ish-kryeministër i Bosnje-Hercegovinës, i përcaktuar për minimin e proceseve dhe institucioneve demokratike.

10. **Aqif Rakipi:** ish-deputet në Shqipëri, i përcaktuar për përfshirje në korrupsion.

11. **Asim Saralji:** ish-deputet në Bosnje-Hercegovinë, i përcaktuar për përfshirje në korrupsion.

12. **Alen Seraniç:** ish-ministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i Republikës Serbe në Bosnje-Hercegovinë, i përcaktuar për cenim të sigurisë, paqes dhe bashkëpunimit rajonal si dhe për minimin e proceseve dhe institucioneve demokratike.

13. **Dragan Stankoviç:** ish-Drejtor i Administratës për Çështjet Gjeodezike dhe Pronësore të Republikës Serbe në Bosnje-Hercegovinë, i përcaktuar për pengimin e zbatimit të Marrëveshjes së Dejtonit.

14. **Sillobodan Stankoviç:** një nga individët më të pasur në Bosnje dhe Hercegovinë dhe pronar i Integral Inzenjering A.D. Laktasi, një firmë e madhe inxhinierike në Republikën Serbe në Bosnje dhe Hercegovinë. Stankoviç u përcaktua për shkak të mbështetjes së Millorad Dodikut.

15. **Gordana Tadiç:** ish-kryeprokurore në Bosnje-Hercegovinë, e përcaktuar për minimin e proceseve dhe institucioneve demokratike.

16. **ALTERNATIVNA TELEVIZIJA D.O.O. BANJA LUKA,** subjekt mediatik i përcaktuar si nën kontrollin e Millorad Dodik.

17. **I.C.I.C. KFT:** kompani hungareze e regjistruar në Pecel, Hungari, e përcaktuar si pronë e Nikolla Gruevskit.

18. **INTEGRAL INZENJERING A.D. LAKTASI:** firmë e madhe inxhinierike në Republikën Serbe të Bosnje-Hercegovinës, e përcaktuar si pronë e Sillobodan Stankoviç.

Implikimet e sanksioneve

Si pasojë e sanksioneve, të gjitha pronat dhe interesat pronësore të individëve ose subjekteve të përcaktuara që gjinden në ShBA ose janë në posedim apo kontroll të personave amerikanë duhet të bllokohen dhe të raportohen në OFAC.

Rregulloret e OFAC në përgjithësi ndalojnë të gjitha transaksionet nga personat ose personat amerikanë, atyre brenda apo në tranzit në ShBA me pronat ose intereset pronësore e personave të përcaktuar në listën SDN. Çdo shkelje e urdhrit ekzekutiv 14033 mund të përballet me dënime civile ose penale.

Përveç kësaj, individët e përcaktuar publikisht kanë ndalesë udhëtimi në ShBA. Për më tepër, Departamenti i Shtetit përcakton edhe anëtarët e ngushtë të familjes së individëve të përcaktuar, të cilëve gjithashtu iu ndalohet udhëtimi për në ShBA.

Përcaktimi i Ramiz Merkos për korrupsion masiv

Përcaktimi i fundit publik nga Departamenti i Shtetit u publikua më 20 qershor 2023 dhe ka të bëjë me Ramiz Merkon, kryetar i komunës së Strugës dhe anëtar i kryesisë së Bashkimit Demokratik për Integrim.

Departamenti i Shtetit thekson se “Derisa shërbente si kryetar i komunës së Strugës, Merko shpërdoroi fondet dhe ndërhyri në

ⁱ <https://ofac.treasury.gov/sanctions-programs-and-country-information>

ⁱⁱ <https://sanctionssearch.ofac.treas.gov/>

ⁱⁱⁱ <https://home.treasury.gov/policy-issues/financial-sanctions/faqs/topic/1521>

^{iv} <https://www.federalregister.gov/documents/2001/06/29/01-16668/blocking-property-of-persons-who-threaten-international-stabilization-efforts-in-the-western-balkans>

^v <https://www.federalregister.gov/documents/2003/05/29/03-13694/termination-of-emergencies-with-respect-to-yugoslavia-and-modification-of-executive-order-13219-of>

^{vi} <https://www.state.gov/public-designation-of-albanian-sali-berisha-due-to-involvement-in-significant-corruption/#:~:text=Public%20Designation%20of%20Albanian%20S>

procese gjyqësore dhe procese të tjera publike, duke dëmtuar besimin e publikut në institucionet dhe zyrtarët demokratikë të Maqedonisë së Veriut”.^{viii}

Ashtu si në rastin Berisha, sanksionet ndaj Merkos janë ndalesa e udhëtimit drejt ShBA-ve, duke përfshirë familjen e tij të ngushtë, por pas sanksione ekonomike. Njësoj si në rastin Berisha, **baza ligjore e përcaktimit është seksioni Seksioni 7031(c) mbi anti-kleptokracinë dhe të drejtat e njeriut i Ligjit buxhetor (viti 2023) të Departamentit të Shtetit, operacioneve të jashtme dhe programeve të ndërlidhura.**

.....

Kontakt

E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org
info@idea.org.mk

Web: www.ipp-arbenxhaferi.org
www.idea.org.mk

<https://www.federalregister.gov/documents/2021/06/10/2021-12382/blocking-property-and-suspending-entry-into-the-united-states-of-certain-persons-contributing-to-the>

<https://www.federalregister.gov/documents/2021/06/10/2021-12382/blocking-property-and-suspending-entry-into-the-united-states-of-certain-persons-contributing-to-the>

^{vii} <https://www.federalregister.gov/documents/2021/06/10/2021-12382/blocking-property-and-suspending-entry-into-the-united-states-of-certain-persons-contributing-to-the>

^{viii} <https://www.state.gov/designation-of-ramiz-merko-north-macedonia-for-significant-corruption/#:~:text=for%20Significant%20Corruption-Designation%20of%20Ramiz%20Merko%2C%20Mayor%20of%20Struga,North%20Macedonia%2C%20for%20Significant%20Corruption&text=The%20United%20States%20is%20designating,his%20involvement%20in%20significant%20corruption>